

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"REVOLUTION ALBANIA" shpk**

Në Tiranë, sot më datë 24.09.2021, ne të poshtëshënuarit:

- 1- **Fisnik Gashi**, i datëlindjes **29.06.1980**, lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **1004147711** dhe numër pasaporte **P00545664**,
- 2- **Kujtim Shala**, i datëlindjes **28.01.1984**, lindur në Sllatinë e madhe dhe banues në Fushë Kosovë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **1011335507** dhe numër pasaporte **P01574918**

me cilësinë e "ortakut themelues" deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, "**REVOLUTION ALBANIA**" shpk,

Neni 1  
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin "**REVOLUTION ALBANIA**", dhe formë ligjore: "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3  
Selia

Shoqëria e ka selinë në adresë: SHYQRI DEMNËRI PALLATI 78/6  
SHKALLA 2, KP. 13 TIRANË

Neni 4  
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Distribuim- shitja me shumice dhe pakice e produkteve Kozmetike, Grimi, produkteve higjienike personale, kremave per fytyre dhe trup, ngjyra te flokut etj

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në 2 kuote, i cili zotërohet si më poshtë:

FISNIK GASHI, zotëron 1 kuotë me vlerë 49.000 lekë, e cila përbën 49 % të kapitalit të shoqërisë  
KUJTIM SHALA, zotëron 1 kuotë me vlerë 51.000 lekë, e cila përbën 51 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e

- pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9  
Administrimi

Administrator i shoqërisë është:

- **Fisnik Gashi**, i datëlindjes **29.06.1980**, lindur në **Prishtinë** dhe banues në Prishtinë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal **1004147711**, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Neni 10  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortak themelues të shoqërisë tregtare "**REVOLUTION ALBANIA**" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAK THEMELUES**

Fisnik GASHI  


KUJTIM SITALA  
